

URDHËR
Nr.193, datë 20.3.2020

PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me urdhrin nr. 208, datë 30.3.2020, nr. 255, datë 10.4.2020, nr. 256, datë 10.4.2020, nr. 278, datë 25.4.2020)

I përditësuar

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Lejohen të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00–17:30, duke filluar nga dita e hënë, datë 13.4.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.

1/1. Hyrja në aktivitetet e përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri lejohet vetëm për një person, të autorizuar, për çdo familje, për kryerjen e shpenzimeve familjare ditore. Autorizimi do të jetë vetëm një herë në ditë dhe do të ketë një afat prej 2 (dy) orësh, gjatë fashës orare 05:00 deri në 17:30.

Hyrja në të gjitha dyqanet/njësitë tregtare që lejohet të hapen duhet të bëhet me radhë, duke ruajtur distancën e sigurisë prej 1.5 m nga njëri-tjetri. Çdo dyqan/njësi tregtare duhet të sigurojë maska dhe doreza për punonjësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe solucion dezinfektues për të gjithë personat që hyjnë në ambientet e dyqanit/njësisë tregtare.

2. Kufizimin e lëvizjes, në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotorë, motomjete dhe mjete) si dhe ndalimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga aktivitetet e lejuara, çdo fundjavë, duke filluar nga e premja ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00. Përfshihen nga ky rregull të gjitha mjetet e transportit të mallrave dhe të produkteve ushqimore, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, njësitë kritike të shërbimeve shtetërore dhe atyre të kompanive mediatike, si dhe shërbimet në banesë (delivery).

3. Ndalohet ofrimi i shërbimit ndaj qytetarëve nga të gjitha aktivitetet, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 1, dhe në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga e premja, datë 17.4.2020 e në vijim, nga ora 17:30 deri të hënën në orën 05:00, deri në një urdhër të dytë. Lista me aktivitetet e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur këtij urdhri hyn në fuqi në orën 05:00 të datës 24.3.2020.

3/1 Lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur urdhrit nr. 193, datë 20.3.2020, “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kategorizuara me risk të ulët sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga dita e hënë, datë 27.4.2020, e në vijim, në intervalin kohor prej orës 5:00, deri në orën 17:30. Këto aktivitete do të ushtrojnë veprimtarinë vetëm në bazë të protokolleve të miratuara në urdhrin nr. 266, datë 21.4.2020, “Për përcaktimin e kategorive të bizneseve sipas niveleve të riskut dhe miratimit të protokolleve të masave higjieno-sanitare dhe distancimit social për parandalimin e përhapjes së COVID-19”.

4. Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore, dhe të gjitha aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur këtij urdhri, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itinerarin shtëpi–punë.

5. Çdo rregull i përcaktuar nga urdhrat e mëparshëm, që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

(ndryshuar me urdbrin nr. 208, datë 30.3.2020)

46	Gomisteri	Lejohen
68	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara	Lejohen
70	Shitje me pakicë për kancelari dhe pajisje të zyrës	Lejohen

(shtuar me urdbrin nr. 278, datë 25.4.2020)

Statusi	Klasa	Klasa _ Përshkrimi
Lejohen	4719	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara.
Lejohen	4771	Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4778	Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara.
Lejohen	4932	Aktiviteti i taksive.
Lejohen	4751	Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara.
Lejohen	4772	Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara.
Lejohen	9609	Aktivitete të tjera p.k.t.
Lejohen	4759	Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në dyqane të specializuara p.k.t.
Lejohen	4776	Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara.
Lejohen	4777	Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4743	Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	5920	Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës.
Lejohen	4753	Tregtia me pakicë e qilimave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dysHEMEVE në dyqane të specializuara.
Lejohen	4765	Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara.
Lejohen	4763	Tregtia me pakicë e regjistruarve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara.
Lejohen	4764	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara.
Lejohen	4742	Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuara/pajisjet e telekomunikacionit në dyqane të specializuara.